

Hapet thirrja për bursa në kuadër të Programin Erasmus + KA 2, për Projektin K-force

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në kuadër të programit Erasmus + KA2, për stafin akademik të UT-së, i cili merret me manaxhimin e projektit K- Force.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e stafit akademik për trajnim, i cili merret me manaxhimin e projektit K-Force;

Universitetet në të cilat do të kryhet mobiliteti;

-Universiteti UkiM, Shkup, Maqedoni

-Universiteti Žilina, Sllovaki

-Universiteti Aalborg, Danimarkë

-Universiteti Lund, Suedi

Kohëzgjatja e bursave:

-Universiteti UkiM, Shkup, Maqedoni (11 Prill – 21 Prill 2018 + 1 ditë udhëtimi)

-Universiteti Žilina, Sllovaki (23 Prill – 4 Maj 2018 + 1 ditë udhëtimi)

-Universiteti Aalborg, Danimarkë (7 Maj – 18 Maj 2018 + 1 ditë udhëtimi)

-Universiteti Lund, Suedi (4 Qershor – 15 qershor 2018 + 1 ditë udhëtimi)

Bursat përfshijnë:

-Universiteti UkiM, Shkup, Maqedoni (180 EUR udhëtimi + 120 EUR / ditë)

-Universiteti Žilina, Sllovaki (275 EUR udhëtimi + 120 EUR / ditë)

-Universiteti Aalborg, Danimarkë (275 EUR udhëtimi + 160 EUR / ditë)

-Universiteti Lund, Suedi (275 EUR udhëtimi + 160 EUR / ditë)

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për trajnim:

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj B2 (Anglisht);
- Letër Suporti nga Koordinator i Projektit;
- Plani i mobilitetit për Trajnim*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf

*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Afati për aplikim: 15 Mars 2018

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt, emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe universitetin në të cilin po aplikoni.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!